



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1215/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Idriz Ibrahimimi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Idriz Ibrahimimi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Viti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovë (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:30 nga Idriz Ibrahimimi kandidat për anëtar të kuvendit komunal, duke pretenduar se në vendvotimin nr:2610D në fshatin Remnik dhe në vendvotimin 2610D/01R dhe 2610D/02D janë bërë parregullsi pasi që pretendon se ka pasur 64 vota dhe nuk janë shënuar në FRP ,andaj kërkoj që të behet rinumërimi i këtyre VV, thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunale nga radhët e LDK-së, Idriz Ibrahimimi konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur ankesës dëshmi bindse me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1215/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.